

UDHËZIM
Nr. 18, datë 4.8.2026

**PËR KËRKESAT PËR PËRSHTATJEN E EMRIT TË VARIETETIT, PROCEDURAT
DHE AFATET E REGJISTRIMIT, ÇREGJISTRIMIT DHE RINOVIMIT TË REGJISTRIMIT
TË VARIETETEVE, SI DHE FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E KËRKESËS PËR
RINOVIMIN E REGJISTRIMIT NË KATALOGUN KOMBËTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 34, të pikës 3, të nenit 35, të pikës 3, të nenit 36 dhe të pikës 4, të nenit 37, të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim përcakton kërkesat për përshtatjen e emrit të varietetit, procedurat dhe afatet për regjistrimin, procedurat për çregjistrimin dhe rinovimin e regjistrimit të varieteteve në Katalogun Kombëtar të varieteteve të specieve të bimëve bujqësore, si dhe formën dhe përmbajtjen e kërkesës për rinovimin e regjistrimit, për varietetet, materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i të cilave prodhohet, përgatitet për treg, importohet dhe tregtohet në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar.

2. Dispozitat e këtij udhëzimi nuk zbatohen për varietetet, farën ose materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të destinuar për eksport në vendet e tjera, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.

KREU II
REGJISTRIMI, KUSHTET DHE TESTIMI I VARIETETEVE NË KK

Neni 2
Regjistrimi në Katalogun Kombëtar

1. Varietetet që plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 10416 datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar, i propozohen Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve për regjistrim në Katalogun Kombëtar, bazuar në rezultatet e vlerësimit teknik të kryer nga ESHFF-ja.

2. Në rastin e varieteteve përbërëse, përfshirë linjat e inbride dhe hibridet, të destinuara vetëm si komponentë prindërorë për prodhimin e varieteteve përfundimtare, dispozitat e pikës 1 të këtij neni zbatohen vetëm në masën që materiali mbjellës dhe shumëzues bimor që u përket këtyre varieteteve tregtohet me emërtimin e tyre.

3. Për qëllim të vlerësimit teknik për varietetet e paraqitura për regjistrim në Katalogun Kombëtar, ESHFF-ja mund të kërkojë dhe të shkëmbejë informacion teknik, përfshirë rezultatet e testeve për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet, me autoritetet kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe me organizmat e njohur ndërkombëtarë në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

4. ESHFF-ja siguron që varietetet që vijnë nga shtete të tjera t’u nënshtrohen të njëjtave kërkesa, veçanërisht lidhur me procedurën e regjistrimit në Katalogun Kombëtar, si dhe kërkesave të tjera të regjistrimit, njësoj si varietetet vendase.

¹ *Ky udhëzim është përafruar pjesërisht me direktivën 2002/53/EC të Këshillit, datë 13 qershor 2002, “Për katalogun e përbashkët të varieteteve të specieve të bimëve bujqësore”; nr. CELEX 02002L0053-EN. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 193, datë 20.7.2002.*

5. Kërkesa për regjistrimin e varietetit paraqitet sipas formularit të përcaktuar në shtojcën I, bashkëlidhur këtij udhëzim.

Neni 3

Kushtet të tjera dhe përjashtimet për regjistrimin e varieteteve

1. Varietetet pranohen për regjistrim në Katalogun Kombëtar vetëm nëse janë të dallueshme, të qëndrueshme dhe mjaftueshëm uniforme. Varietetet duhet të kenë vlerë të kënaqshme për kultivim dhe përdorim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Verifikimet kryhen nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim dhe metodologjitë teknike të zbatueshme, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi.

3. Regjistrimi i varieteteve të modifikuara gjenetikisht kryhet vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon organizmat e modifikuar gjenetikisht.

4. Për varietetet që përdoren në ushqim ose ushqim për kafshë zbatohen kërkesat e legjislacionit në fuqi për sigurinë ushqimore, ushqimin për kafshë dhe, sipas rastit, legjislacioni për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Neni 4

Dallueshmëria, qëndrueshmëria, uniformiteti dhe vlera për kultivim dhe përdorim

1. Vlerësimi i dallueshmërisë, uniformitetit dhe qëndrueshmërisë (DUS), si dhe i vlerës për kultivim dhe përdorim (VCU), kryhet në përputhje me metodologjitë dhe standardet teknike të miratuara sipas legjislacionit në fuqi, duke zbatuar, sipas rastit, protokollet dhe udhëzimet teknike të organizmave ndërkombëtarë të njohur në fushën e testimit të varieteteve.

Neni 5

Kërkesat për testimin, vlerësimin dhe regjistrimin e varieteteve në Katalogun Kombëtar

1. ESHFF-ja kryen testimet zyrtare dhe përgatit vlerësimin teknik për dallueshmërinë, uniformitetin, qëndrueshmërinë dhe vlerën për kultivim dhe përdorim, të cilin ia paraqet Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve për vendimmarrje. Metodatat e përdorura për përcaktimin e karakteristikave duhet të jenë të sakta dhe të besueshme. Për përcaktimin e dallueshmërisë, provat e kultivimit përfshijnë të paktën varietete krahasuese të disponueshme dhe të njohura në momentin e vlerësimit, sipas pikës 1, të nenit 5 të këtij udhëzimi. Për qëllim të zbatimit të nenit 9 të këtij udhëzimi, përfshihen edhe varietete të tjera krahasuese të disponueshme.

2. Karakteristikat minimale të testeve dhe kërkesat teknike për vlerësimin e dallueshmërisë, uniformitetit, qëndrueshmërisë dhe vlerës për kultivim e përdorim zbatohen në përputhje me metodologjitë dhe standardet teknike të miratuara sipas legjislacionit në fuqi.

3. Trajtimi i informacionit teknik dhe i të dhënave që përbëjnë sekret tregtar ose informacion konfidencial bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, të ndryshuar, si dhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e sekretit tregtar dhe të informacionit konfidencial.

4. Regjistrimi i varieteteve të modifikuara gjenetikisht kryhet vetëm pasi të jenë përmbushur kërkesat e legjislacionit në fuqi për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

5. Për varietetet, materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i të cilave përdoret në ushqim ose ushqim për kafshë, zbatohen kërkesat e legjislacionit në fuqi për sigurinë ushqimore, ushqimin për kafshë dhe, sipas rastit, legjislacioni për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Neni 6

Detyrimi për deklaram të kërkesave në shtete të tjera

Gjatë paraqitjes së kërkesës për regjistrimin e një varieteti në Katalogun Kombëtar, aplikanti deklaron nëse për të njëjtin varietet është paraqitur kërkesë për regjistrim edhe në një shtet tjetër, cilin shtet përfshin kërkesa dhe nëse ajo është miratuar ose është në proces shqyrtimi. Ky informacion përdoret nga ESHFF-ja vetëm për qëllime të verifikimit teknik dhe bashkëpunimit administrativ gjatë shqyrtimit të kërkesës.

KREU III EMËRTIMI I VARIETETEVE

Neni 7

Kriteret e emrit dhe përdorimi në Katalog

1. ESHFF-ja siguron publikimin zyrtar të Katalogut Kombëtar të varieteteve të pranura në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të emrit të personit ose personave përgjegjës për mirëmbajtjen e varietetit. Kur për një varietet ka më shumë se një person përgjegjës për mirëmbajtjen, publikimi i emrave mund të mos kryhet. Nëse emrat nuk publikohen, Katalogu Kombëtar duhet të tregojë autoritetin që administron listën e personave përgjegjës për mirëmbajtjen e varietetit.

2. ESHFF-ja siguron që në momentin e regjistrimit të varietetit, ai të njihet me të njëjtin emër në të gjitha rastet e regjistrimit dhe tregtimit.

Nëse konstatohet se fara ose materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i një varieteti tregtohet në një vend tjetër me një emër të ndryshëm, ky emër duhet të pasqyrohet edhe në Katalogun Kombëtar.

3. Përshtatshmëria e emrit të varietetit vlerësohet nga ESHFF-ja, në përputhje me ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, të ndryshuar, dhe rregullat ndërkombëtare të zbatueshme për emërtimin e varieteteve.

Ky rregull nuk zbatohet në rastet kur emërtimi mund të shkaktojë konfuzion ose keqkuptim, në lidhje me varietetin përkatës ose kur, në përputhje me rregullat kombëtare për emërtimin e varieteteve, ekzistojnë pengesa të tjera që ndalojnë përdorimin e tij, apo kur të drejtat e palëve të tjera kufizojnë përdorimin e lirë të atij emri për varietetin në fjalë.

4. Kërkesa për përshtatjen e emrit të varietetit paraqitet sipas formularit të përcaktuar në shtojcën II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 8

Dosja dhe emërtimi i varietetit

1. ESHFF-ja harton për çdo varietet të regjistruar një dosje të veçantë, e cila përmban përshkrimin e varietetit dhe një përmbledhje të qartë të të gjitha të dhënave mbi të cilat është bazuar regjistrimi i tij. Përshkrimi i varietetit lidhet me bimët e prodhuara drejtpërdrejt nga fara, si dhe me materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të kategorisë “farë dhe material mbjellës, dhe shumëzues bimor i certifikuar”. Dosja e varietetit hartohet sipas modelit të përcaktuar në shtojcën V, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Varietetet e modifikuara gjenetikisht shënohen qartë si të tilla në Katalogun Kombëtar.

3. Për sa i përket përshtatshmërisë së emërtimit të varietetit, zbatohen rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor. Aplikanti paraqet emrin e ri brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e ESHFF-së, sipas afatit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

4. ESHFF-ja vë në dispozicion të Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve dosjet e parashikuara në nenin 9, pika 1, për varietetet e regjistruara ose për ato që kanë humbur statusin e regjistrimit. Informacioni i shkëmbyer në lidhje me këto dosje trajtohet si konfidencial.

5. Aksesit në dosjet e varietetit garantohen sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave dhe informacionin konfidencial. Kjo dispozitë nuk zbatohet për informacionin që, në përputhje me nenin 6, pika 3 të këtij udhëzimi, trajtohet si konfidencial.

KREU IV ADMINISTRIMI I KATALOGUT KOMBËTAR

Neni 9

Publikimi i Katalogut Kombëtar

1. ESHFF-ja publikon dhe përditëson Katalogun Kombëtar të varieteteve të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Katalogu Kombëtar publikohet në faqen zyrtare të internetit të ESHFF-së.
3. Katalogu Kombëtar përditësohet sa herë që merret një vendim për regjistrimin, rinovimin, korrigjimin, ndryshimin ose çregjistrimin e një varieteti.
4. Katalogu Kombëtar përmban të dhënat sipas urdhrit nr. 1269, datë 26.11.2025, “Për formën dhe përmbajtjen e katalogut kombëtar”.

Neni 10

Njoftimi dhe vënia në dispozicion e informacionit për varietetet e regjistruara

1. Bazuar në përcaktimet në nenin 9, ESHFF-ja njofton aplikuesin për varietetin e regjistruar në katalogun kombëtar bazuar në vendimin e Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve, sipas procedurave që kryhen nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*.
2. Për çdo varietet të ri të regjistruar, ESHFF-ja disponon një përshkrim të shkurtër të karakteristikave të tij kryesore për përdorim. Kjo dispozitë nuk zbatohet për varietetet (linja të *inbreed*-e ose hibride) që janë të destinuara vetëm si përbërës për varietete përfundimtare. Me kërkesë, ESHFF-ja komunikon, gjithashtu, karakteristikat e veçanta që mundësojnë dallimin e varietetit nga varietetet e tjera të ngjashme.
3. Kur regjistrimi i një varieteti refuzohet ose humbet vlefshmërinë, rezultatet e testimeve i vihen në dispozicion aplikantit.
4. Njoftimi për vendimin mbi statusin e varietetit bëhet sipas modelit të përcaktuar në shtojcën VI, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 11

Vlefshmëria dhe zgjatja e regjistrimit të varieteteve

1. Regjistrimi i një varieteti në Katalogun Kombëtar ka vlefshmëri:
 - a) për 20 (njëzet) vjet, për varietetet e bimëve bujqësore;
 - b) për 25 (njëzet e pesë) vjet, për varietetet e pemëve frutore.
2. Afati fillon nga data e marrjes së vendimit të regjistrimit.
3. Regjistrimi mund të rinovohet sipas nenit 13 të këtij udhëzimi.

Neni 12

Sqarimi i dyshimeve pas regjistrimit të varieteteve

1. ESHFF-ja siguron sqarimin e çdo dyshimi që mund të lindë pas regjistrimit të një varieteti, lidhur me vlerësimin e dallueshmërisë ose me emërtimin e tij në momentin e regjistrimit.
2. Kur, pas regjistrimit të një varieteti, konstatohet se kushti i dallueshmërisë nuk ka qenë i përmbushur në momentin e regjistrimit, ESHFF-ja i propozon Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve çregjistrimin e varietetit nga Katalogu Kombëtar, në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë udhëzim. Me anë të këtij vendimi, varieteti, me efekt nga data e regjistrimit fillestar, nuk konsiderohet më si varietet i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, sipas kërkesave të nenit 5 të këtij udhëzimi.

Neni 13

Rinovimi i regjistrimit të varietetit

1. Kërkesa për rinovimin e regjistrimit të varietetit në Katalogun Kombëtar paraqitet nga aplikuesi ose personi përgjegjës i autorizuar prej tij, sipas formularit të përcaktuar në shtojcën III, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Regjistrimi i një varieteti mund të rinovohet në intervale të përcaktuara, nëse varieteti vazhdon të kultivohet në një shkallë që justifikon rinovimin e tij ose duhet të ruhet në interes të ruajtjes së burimeve gjenetike bimore, dhe nëse vazhdojnë të përmbushen kërkesat për dallueshmëri, uniformitet dhe qëndrueshmëri, si dhe kushtet e tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për regjistrimin në Katalogun Kombëtar. Kërkesa për rinovimin e regjistrimit të varietetit paraqitet pranë ESHFF-së, jo më vonë se dy vjet përpara përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së regjistrimit.

3. Periudha e vlefshmërisë së regjistrimit të varietetit zgjatet përkohësisht deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për kërkesën për rinovimin e regjistrimit.

4. ESHFF-ja shqyrton kërkesën për rinovimin e regjistrimit dhe, kur plotësohen kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, miraton rinovimin e regjistrimit të varietetit.

KREU V ÇREGJISTRIMI I VARIETETEVE

Neni 14

Çregjistrimi i varieteteve nga Katalogu Kombëtar

1. ESHFF-ja, pas verifikimit të kushteve të përcaktuara në këtë nen, i propozon Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve çregjistrimin e varietetit nga Katalogu Kombëtar:

a) nëse, pas testimit, konstatohet se varieteti nuk është më i dallueshëm, i qëndrueshëm ose mjaftueshëm uniform;

b) me kërkesë të personit ose personave përgjegjës për mirëmbajtjen e varietetit, përveç rasteve kur sigurohet mirëmbajtja e tij.

2. ESHFF-ja mund të çregjistrojë një varietet nga Katalogu Kombëtar:

a) nëse nuk plotësohen më kushtet që kanë shërbyer si bazë për regjistrimin e varietetit;

b) nëse, gjatë paraqitjes së kërkesës për regjistrim ose gjatë testimit, janë paraqitur të dhëna të rreme ose mashtruese mbi bazën e të cilave është kryer regjistrimi.

3. Vendimi për çregjistrimin merret nga Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve.

4. Kërkesa për çregjistrimin e varietetit paraqitet sipas formularit të përcaktuar në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 15

Periudha kalimtare për certifikimin dhe tregtimin pas çregjistrimit

1. Pas vendimit për çregjistrim ose pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së regjistrimit, varieteti hiqet nga Katalogu Kombëtar.

2. Periudha kalimtare për certifikimin dhe tregtimin zbatohet sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

KREU VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Ngarkimi i strukturave

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF) dhe struktura përgjegjëse në MBZHR që mbulon materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

SHTOJCA I
FORMULARI I KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E VARIETETIT NË KATALOGUN
KOMBËTAR

1. Të dhënat e aplikantit
Emri/mbiemri ose emërtimi i subjektit: _____
Adresa: _____
NIPT/numri i identifikimit: _____
Kontakti (telefon/*email*): _____
2. Personin përgjegjës për mirëmbajtjen e varietetit
Emri/mbiemri: _____
Adresa: _____
3. Specia: _____
4. Emrin e propozuar të varietetit: _____
5. Origjina: _____
6. Informacion për regjistrimin në vende të tjera
Shteti/shtetet ku është paraqitur kërkesa ose është regjistruar: _____
Statusi i regjistrimit: _____
7. Regjistri historik i varieteteve të çregjistruara të tjera: _____
8. Deklaratën për OMGJ-të (kur aplikohet): _____
9. Dokumentet shoqëruese.

SHTOJCA II
FORMULARI I KËRKESËS PËR PËRSHTATJEN E EMRIT TË VARIETETIT
PËR RASTET SIPAS NENIT 34 TË LIGJIT

1. Emrin aktual të varietetit: _____
2. Arsyeën e papërshtatshmërisë së emrit: _____
3. Propozimin për emrin e ri: _____
4. Deklaratën e aplikantit.
Unë, _____, deklaroj se informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i saktë dhe se emri i propozuar i varietetit është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
Data: _____
Emri dhe nënshkrimi i aplikantit: _____

SHTOJCA III
FORMULARI I KËRKESËS PËR RINOVIMIN E REGJISTRIMIT TË VARIETETIT

1. Emrin e varietetit: _____
2. Numrin e regjistrimit në KK: _____
3. Datën e regjistrimit fillestar: _____. _____. _____. _____
4. Aplikantin/personin përgjegjës
Emri/mbiemri: _____
Adresa: _____
5. Arsyetimin për rinovim: _____
6. Deklaratën që varieteti vazhdon të ruhet

- ☐ Deklaroj se varieteti vazhdon të ruhet dhe plotëson kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
7. Dokumentet teknike shoqëruese.

SHTOJCA IV
FORMULARI I KËRKESËS PËR ÇREGJISTRIMIN E VARIETETIT

1. Emrin e varietetit: _____
2. Numrin e regjistrimit: _____
3. Personin që kërkon çregjistrimin:
Emri/mbiemri: _____
Adresa: _____
4. Arsyeja e kërkesës për çregjistrim:
☐ Nuk prodhohet më;
☐ Nuk ka interes ekonomik;
☐ Kërkesë e mirëmbajtjesit;
☐ Arsye tjetër: _____
5. Datën e kërkuar të heqjes nga KK-ja: ____ . ____ . ____

SHTOJCA V
MODELI I DOSJES SË VARIETETIT TË REGJISTRUAR

- Përmban:
1. Formularin e aplikimit;
 2. Përshkrimin zyrtar të varietetit;
 3. Rezultatet DUS;
 4. Rezultatet VKP (kur kërkohet);
 5. Raportet e provave;
 6. Vendimin e KRV-së;

SHTOJCA VI
NJOFTIM PËR VENDIMIN MBI STATUSIN E VARIETETIT NË KATALOGUN KOMBËTAR

MODEL
ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE

Nr. ____ prot.
Datë ____ . ____ . ____

NJOFTIM

Për: _____
(emri i aplikantit/personit përgjegjës)
Adresa: _____
Lënda: Njoftim mbi vendimin për varietetin _____

Në zbatim të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar, dhe udhëzimit “Për kërkesat për përshtatjen e emrit të varietetit, procedurat dhe afatet e regjistrimit, çregjistrimit dhe rinovimit të regjistrimit të varieteteve në Katalogun Kombëtar...”, ju njoftojmë se:

1. Të dhënat e varietetit
Specia bimore: _____
Emri i varietetit: _____
Kodi i aplikimit/regjistrimit: _____
Kategoria e përdorimit: _____

2. Lloji i vendimit

- ☐ Regjistrim në Katalogun Kombëtar;
- ☐ Rinovim i regjistrimit Çregjistrim nga Katalogu Kombëtar;
- ☐ Refuzim i kërkesës.

3. Vendimi

Bazuar në:

- rezultatet e ekzaminimit teknik;
- rezultatet e provave DUS;
- rezultatet e VKP-së (kur aplikohet);
- dokumentacionin e paraqitur nga aplikanti;

vendoset:

4. Data e hyrjes në fuqi të vendimit

_____._____._____

5. Afati i vlefshmërisë së regjistrimit (kur aplikohet)

Nga: _____._____._____

Deri më: _____._____._____

6. Arsyetimi (kur bëhet refuzim):

7. Publikimi

Vendimi do të publikohet në Katalogun Kombëtar dhe në faqen zyrtare www.eshff.gov.al.